



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-5067/23 datë:21.02.2023



Npi – 01/64 datë: 28.02.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.02.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 28.02.2023, (e martë) në ora 09.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Të gjithë Drejtorët, Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi, Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti, Nga OSBE, z.Mefail Mustafa, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Praktikantët, z.Shqiprim Hyseni dhe znj.Valmira Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.01.2023,
2. Pyetje – përgjigje,
3. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023 (pas diskutimit publik),
4. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021,
5. Raport financiar për vitin 2022 - Pasqyrat financiare,
6. Draft-Rregullore për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve,
7. Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 (Pas diskutimit publik),
8. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje 2023-2025,
9. Draft – Plani Komunal për Integritet 2023-2027,
10. Propozim-Vendim për ndarjen e lokacionit për objektin e ngushëllimeve të lagjes Sahiti dhe Musolli në fshatin Pjetërshic.
11. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme,
12. Informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë shkollor 2022/23,

13. Rekomandim për Ministrinë e Financave për faljen e 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës Kryesuesi i ftoj të pranishmit për një minutë heshtje në shenjë të përkujtimit të 4 personave të Komunës sonë që e humbën jetën para pak ditësh në aksidentin tragjik të komunikacionit në rrugën Shtime-Ferizaj.

Kryesuesi i urojë Kryetarit z.Qemajl Aliu lindjen e djalit, duke i uruar shëndet dhe jetë të gjatë.

Në Vazhdim Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, te pika e 5 “Raport financiar për vitin 2022 - Pasqyrat financiare” unë propozoj që të jetë Informatë e jo Raport.

z.Rexhep Gashi; Deri sa mbledhja nuk ka përfunduar, si e thirrri Kryesuesi mbledhjen e dytë, unë mendoj se duhet të vazhdojë mbledhja e parë.

z.Reshat Mujota; Pajtoj me parafolësin dhe me rendin e ditës. Te pikat e rendit të ditës duhet të vazhdojmë me pikat e mbledhjes së parë. Ju si Vetëvendosje keni thënë se do ta thirrni një mbledhje të Jashtëzakonshme. Ne kompetent nuk jemi as me i rekomandu Ministrisë, për sa i përket pikës së 13 të rendit të ditës. Unë kërkoj që të vazhdohet me pikën e 12, e pastaj me të tjerat.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, ngushëllime familjarëve për këto katër raste të aksidentuara në komunën tonë. Urime Kryetarit lindjen e djalit. Pajtoj me parafolësit. Unë mendoj se duhet të vazhdojë mbledhja e parë e cila nuk ka përfunduar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sqaroi se unë jam thirrur në Ligj. Ju e keni të drejtën e ankesës në Ministri. Pika e fundit e mbledhjes është qitë në votim dhe nuk ka kaluar, kështu që mbledhja ka përfunduar.

z.Përparim Ramusa; Rregullorja e thotë kështu, që propozimin e dytë nuk e ke qitë në votim, për ata shumica e Kuvendarëve e kanë lëshuar mbledhjen.

z.Reshat Mujota; Kallxo a ke bërë shkelje ligjore, nëse bënë unë prapë do ta lëshojë mbledhjen, nëse i neglizhon anëtarët e Kuvendit.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, Kryesuesi e ka për obligim me e ruajtur ligjshmërinë e Kuvendit. Kryesuesi nuk mundet me qitë në votim diçka që është në kundërshtim me Ligjin. Nuk ka të drejtë subjekti i PDK-së me ja caktuar Vetëvendosjes se cilin kandidat me e qitë për KPF-ë, sepse kjo është e pa ligjshme. Mirëpo nëse mendoni se keni të drejtë ju mund të bëni ankesë në Ministri.

z.Rexhep Gashi; Kryesuesi nuk mundet me e shkelë Ligjin. Kryesuesi nuk mundet mos me e qitë në votim propozimin e asamblistit.

z.Adem Ramadani; Përshëndetje, unë mendoj se Zyrtari Ligjor mundet me na e dhënë një shpjegim.

z.Besnik Seferi; Meqenëse ne nuk i kemi numrat, opozita mund t'i bojkotojë të gjitha mbledhjet. Zyrtari Ligjor mundet me na dhënë sqarime, mirëpo anëtari i cili duhet ta zëvendësojë Heroina Selmanin duhet të jetë nga subjekti politik i Vetëvendosjes.

z.Reshat Mujota; Po habitem me parafolësin, lexoe Udhëzimin Administrativ, mbaje fjalën e mos dil kundër vetvetes.

z.Besnik Seferi; Nëse po flitet për parime unë i mbajë parimet e mija, unë nuk jam kundër askujt. Është e turpshme të bëhen lojna të tilla.

z.Përparim Ramusa; Në emër të PDK-së, pikërisht që Kuvendi mos me qenë objekt tallje, unë kërkoj që ju ta respektoni Ligjin. Kërkoj që ta vazhdoni mbledhjen e parë. Ku e dini ju se si kishim me votuar.

z.Reshat Mujota; Me Besnikun nuk dua me repliku, në procesverbal thotë se ti nuk ke pas kuorum.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Unë nuk kam qenë prezent në mbledhjen e kaluar. Në Ligje nuk po mundem me gjete atë çka po kërkon ju, prandaj ju duhet me bërë një kërkesë me shkrim, dhe pastaj unë të përgjigjem me shkrim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Zotëri Lulzim Muharremi, si zyrtarë ligjor na e sqaroni se si bëhet një zëvendësim i një anëtari në Komitetin për Politikë dhe Financa?

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Kjo praktikë nuk ka ndodhur asnjëherë, sa e di unë.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, mendoj se ka qenë mirë që të ulen të gjitha grupet parlamentare dhe t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre, me një pauzë dhe pastaj të vazhdojmë.

z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, neni 47 i LVL-së, thotë: Në vazhdim e lexoi tekstin dhe tha, ju nuk e keni qitë në votim propozimin, dhe për këtë arsye ne e kemi lëshuar mbledhjen. Çështjen e interpretimit ligjor e bënë zyra ligjore e Ministrisë. Kemi pas përvoja të tilla, kështu që unë po kërkoj që ta zbatoni Ligjin dhe ta hidhni në votim. Kështu që ne do ta lirojmë sallën e ju folni me zyrtarin ligjor, dhe ne pastaj do të vijmë në mbledhje pasi të vendosni.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sqaroi për mënyrën se si zëvendësohet një anëtarë e KPF-së sipas ligjit, ajo duhet të vijë nga subjekti i njëjtë politik edhe nga struktura e njëjtës gjinore, ndryshe na prishet krejt struktura e ndërtimit të Komiteteve tjera. Dëgjoni se çka thotë Rexha, ne e dimë që Ministria e kthen e që nënkupton se ne po duam me e shkelë ligjin, por ti qite në votim.

z.Përparim Ramusa; Kryesues ne nuk mundemi me e vazhduar këtë mbledhje, pa e vazhduar mbledhjen e parë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Përparim ti i ke votuar pikat në KPF-ë, ato pika kanë qenë pika në përputhje me pikat e Kuvendit, pse nuk ke thënë atëherë asgjë?



Po marrim pra 10 minuta pauzë në ora 10:15 h, dhe pastaj kërkoj që mbledhjen ta vazhdojmë në ora 10:45h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po vazhdojmë me mbledhjen 10:45 h, meqenëse në sallën e Kuvendit nuk janë prezent anëtarët e opozitës, e thërras asistenten znj.Gentiana Mehmetin që të dalë në hollin e Kuvendit dhe t'i thërras anëtarët tjerë të Kuvendit që të vijnë në mbledhje.

znj.Gentiana Mehmeti; Në korridor Kryesues nuk ka asnjë anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fillimisht konstatoj se në sallën e Kuvendit i kemi 10 anëtarë të Kuvendit prezent, dhe meqenëse në sallë na mungojnë 11 anëtarë, atëherë sipas Ligjit jam i obliguar që ta ndërpresë mbledhjen e dytë të Kuvendit të Komunës së Shtimes, për arsye të mungesës së Kuorumit, në ora 10:50h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

